



***Нарни** dritaret*

Projekt për e-arsim (arsim elektronik)
të disponueshëm

**RAPORT NGA HULUMTIMI:
SHKOLLAT E MESME NË MAQEDONI DHE
TEKNOLOGJIA ASISTUESE**

Shkup, prill 2014

Botues:

Shoqata „Hapni dritaret “,
bul. Partizanski odredi 62/2-29, Shkup
www.openthewindows.org

Ekipi hulumtues:

Vladimir Llazovski, udhëheqës i ekipit dhe bashkë-autor
Margarita Gulevska, bashkë-autor
Radmilla Stojkovska-Aleksova
Magdalena Dimkova-Velevska
Ollga Samarxhiq-Jankova
Marija Velinovska
Aleksandra Spasovska

Hulumtimi është i financuar nga populli amerikan nëpërmjet Agjencisë së SHBA për zhvillim ndërkombëtar - USAID, që është pjesë e misionit të SHBA në Republikën e Maqedonisë. Aktiviteti është i zbatuar në kuadër të Projektit të USAID për e-arsim (arsim elektronik) të disponueshëm.

Zbatimi i hulumtimit është i mbështetur nga Ministria e arsimit dhe shkencës dhe Byroja për zhvillim të arsimit (shkresë drejt MASH nr. 11-7627/4-19 nga 28.01.2014).

Ky raport nuk i shpreh qendrimet e USAID ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhe as të Ministrisë së arsimit dhe shkencës së Republikës së Maqedonisë ose të Byrosë për zhvillim të arsimit.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	Error! Bookmark not defined.
1. HYRJJE.....	4
Definim të nocioneve kyçe	Error! Bookmark not defined.
Metodologjia.....	Error! Bookmark not defined.
Përpunim dhe paraqitje të rezultateve	Error! Bookmark not defined.
Ekipi hulumtues.....	Error! Bookmark not defined.
2. GJETJE	7
Karakteristika të mostrës.....	Error! Bookmark not defined.
Përfaqësimi i nxënësve me NVA	Error! Bookmark not defined.
Inkluziviteti i shkollës	Error! Bookmark not defined.
Nxënësit me NVA dhe përdorimi i kompjuterave në mësim	Error! Bookmark not defined.
Nevoja prioritare dhe rekomandime të shkollave	Error! Bookmark not defined.
3. PËRFUNDIME	15
4. REKOMANDIME	16
Shtojca 1: PYETËSOR ANKETUES	17
Shtojca 2: LISTA E SHKOLLAVE TË MESME TË PËRFSHIRA	22
Shtojca 3: VIZITA NËPËR SHKOLLA (faza 2. e hulumtimit)	24

PËRMBLEDHJE

Hulumtimi i nevojave të shkollave të mesme për teknologji informatike asistuese zbatohet për herë të parë në Maqedoni. Mundimet afatgjata të autoriteteve arsimore për krijim të sistemit modern dhe inkluziv arsimor, duke e përfshirë arsimin e mesëm, i sigurojnë parakushtet e nevojshme për zbatimin e teknologjisë asistuese në mësimdhënie.

Nëpërmjet metodës së anketës ishin përfshirë tre të katërtat e të gjitha shkollave të mesme të rregullta në vend, që është përfaqësimi i shkëlqyer i shembullit të përfshirë.

Gjetjet janë të grupuara sipas tre çështjeve hulumtuese kyçe:

- përfaqësimi i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore (NVA),
- inkluziviteti në shkollat e mesme në pikëpamje të nxënësve me NVA, dhe
- aplikimi i kompjuterëve për përfshirje të nxënësve me NVA në mësim.

Pothuajse në dy të tretat e shkollave të mesme ka të paktën nga një nxënës me NVA, që tregon se shkollat po përballen me nevojën ta përshtatin qasjen e tyre dhe të sigurojnë mbështetjen përkatëse. Nxënësit me NVA të përfshirë në shkollat e rregullta po përballen me lloje të ndryshme të pengesave.

Shkollat ende po përballen me sfida në pikëpamje të inkluzivitetit vetjak, duke përfshirë edhe qasjen fizike, personelit të papërshtatshëm të ekipeve profesionale, mungesë të kurseve për mësuesit për punë me nxënës me NVA etj. Megjithatë, pjesa më e madhe e tyre kanë pasur përvoja pozitive me nxënësit me NVA, që janë fituar me dijet themelore të nevojshme dhe e kanë përfunduar suskesshëm arsimin e rregullt të mesëm.

Një e katërta e nxënësve me NVA përballen me vështirësi ose nuk mund ta përdorin pajisjen standarde kompjuterike në shkollat. Janë shënuar vetëm dy shembuj të zbatimit të teknologjisë asistuese në mësimdhënie, edhe pse shkollat janë tepër të vetëdijshme për rëndësinë e teknologjisë së informacionit për mundësitë arsimore të nxënësve me NVA

Hulumtimi ofron rekomandime për futjen dhe përdorimin e teknologjisë asistuese si vegël për përmirësimin e përfshirjes së nxënësve me pengesë në arsimin e mesëm. Përmirësimi i inkluzivitetit të përgjithshëm të shkollave është parakusht i pashmangshëm për atë.

Ky aktivitet është pjesë nga Projekti i USAID për e-arsim (arsim elektronik) të disponueshëm që e zbaton shoqata "Hapni dritaret". Hulumtimi ishte i zbatuar në bashkëpunim me Ministrinë e arsimit dhe shkencës (MASH) dhe Byroja për zhvillim të arsimit (BZHA)

1. HYRJE

Në këtë raport janë paraqitur gjetjet kyçe, përfundimet dhe rekomandimet nga hulumtimi për nevojat e zbatimit të teknologjisë asistuese në mësim në shkollat e mesme në Maqedoni. Të dhënat sillen për vitin shkollor 2013/14.

Para hulumtimit ishin vendosur dy qëllime:

- 1) të dokumentohet gjendja në shkollat e mesme në pikëpamje të aplikimit të kompjuterëve si vegël për përmirësim të cilësisë së arsimit të nxënësve me nevoja të veçanta arsmiore, dhe
- 2) të identifikohen nevojat dhe mundësitë për aplikim të teknologjisë asistuese në procesin mësimor.

Motivim për zbatimin e hulumtimit ishte fakti se arsimi i mesëm u bë i detyrueshëm për të gjithë nxënësit në Maqedoni nga viti 2008. Pra, teknologjia asistuese, deri tani çështje shumë pak e hulumtuar tek ne, i lidh më së miri angazhimet strategjike të autoriteteve arsimore për sistem inkluziv dhe bashkëkohor arsimor me zbatim të gjerë të teknologjive të informacionit-komunikimit në mësimdhënie.

Hulumtimi është pjesë e Projektit nga USAID për e-arsim (arsim elektronik) të disponueshëm, i zbatuar nga “Hapni dritaret”. Nga viti 2010, projekti luan rol pioner në aplikimin e teknologjisë asistuese në më shumë se 30 shkolla filllore të rregullta në vend.

Detyra praktike projektuese para këtij hulumtimi ishte të zgjidhen dy shkolla të mesme, në të cilat do të pilotohet aplikimi i teknologjisë asistuese në mësim.

Definim të nocioneve kyçe

Për nevojat e këtij hulumtimi, nocioni “**shkolla të mesme**” i përfshin të gjitha shkollat e mesme publike në Maqedoni, me përjashtim të shkollave të mesme të veçanta.

Shprehja “**teknologji asistuese**” përfshin pajisje hardueri, pajisje ndihmë dhe përshtatje softuerike të pajisjes standarde kompjuterike që e mundësojnë ose lehtësojnë përdorimin e kompjuterëve nga ana e personave me pengesë.

“**Pajisje asistimi**” janë pajisje që janë zëvendësim për pajisjet standarde kompjuterike, si: tastierë me butona të mëdha, trakboll, xhojstik të adaptuar, klik të veçuar etj.

Termi “**nxënës me nevoja të veçanta arsimore**” (ose nxënës me NVA) është përdorur në domethënie e saj më të ngushtë që shënon nxënës që përballen me lloj të caktuar pengese. Për shkak të saktësisë terminologjike dhe pajtueshmërisë, shkollave u ishte ofruar listë të llojit të pengesës, që, në kuadër të këtij hulumtimi, ishin të përfshira në grupin e “nxënës me NVA”.

- nxënës me pengesa në zhvillimin psikik,
- nxënës me invaliditet trupor (që kanë vështirësi gjatë lëvizjes së duarve, këmbëve ose të gjithë trupit, paralizë cerebrale, ose që përdorin pajisje ndihmë gjatë lëvizjes si karrige me rrota, paterica etj.),
- nxënës me dëmtime të shikimit (të shkallës më të lartë dhe që e pengojnë nxënësin ta ndjekë mësimin),
- nxënës me dëmtime të dëgjimit (të shkallës më të lartë dhe që e pengojnë nxënësin ta ndjekë mësimin),
- nxënës me multihendikep (invaliditet të kombinuar trupor dhe pengesa në zhvillimin psikik),
- nxënës me autizëm (spektër autik të çrregullimit), dhe

- lloje të tjera të pengesave të papërfshira më lart, të përmendura nga shkollat.

Gjatë emërimit të llojeve të veçanta të pengesave ishin përdorur termat që zakonisht përdoren nga ana e institucioneve arsimore, që ishte kryer që të lehtësohet përfshirja e shkollave në hulumtim.

Metodologjia

Lënda e hulumtimit ishte që të vlerësohen nevojat e teknologjisë informatike asistuese në shkollat e mesme të rregullta në Maqedoni.

Fokusi ishte vendosur në (pyetjet) e mëtejshme **variable**, relevante për vlerësim të nevojave të shkollave të mesme nga zbatimi i teknologjisë asistuese në mësim:

- përfaqësimi i nxënësve me NVA,
- inkluziviteti i shkollave të mesme në pikëpamje të nxënësve me NVA, dhe
- aplikimi i kompjuterëve për përfshirje të nxënësve me NVA në mësim.

Hulumtimi ishte zbatuar në **dy faza**:

Në fazën e parë, nëpërmjet **anketës** ishin përfshirë 96 shkolla të mesme publike në vend, me përjashtim të atyre të veçantave. Pyetësi anketues ishte dorëzuar në formë të shtypur tek drejtorët e shkollave. Në letrën bashkëngjitur ishin shpjeguar lënda dhe qëllimet dhe ishin ndarë definicionet e termave të përdorur kyçe për nevojat e hulumtimit. Të dhënat ishin mbledhur në periudhën janar - shkurt të vitit 2014.

Faza e dytë përfshiu **vizita dhe intervista** në 10 shkolla të mesme të përzgjedhura, për të cilat, sipas rezultateve nga anketa, ishte vlerësuar se kanë nevoja më të mëdha për zbatim të teknologjisë asistuese në mësim. Bashkëbisedues gjatë intervistave ishin përfaqësues të ekipeve profesionale shkollore të obliguar për ndjekje dhe mbështetje të inkluzionit të nxënësve me NVA. Vizitat, e zbatuara në mars të vitit 2014, siguruan informacione dhe përshtypje plotësuese të dorës së parë që ishin shfrytëzuar për zgjedhje të dy shkollave të mesme që do të fitojnë mbështetje për aplikimin e teknologjisë asistuese në mësim.

Përpunim dhe paraqitje e rezultateve

Përgjigjet e fituara ishin përpunuar dhe analizuar në mënyrë kuantitative (statistikisht) dhe në mënyrë kualitative (shpjeguese dhe interpretuese)

Në raportin janë paraqitur gjetjet nga hulumtimi anketues.

Në kapituj të veçantë janë paraqitur përfundimet dhe rekomandimet nga hulumtimi.

Informacione për rezultatet nga vizitat dhe intervistat në funksion të zgjedhjes së shkollave që do të jenë të mbështetura që të aplikojnë teknologji asistuese në mësim janë paraqitur në vijim të këtij raporti.

Ekipi hulumtues

Hulumtimin e kreu ekip i Shoqatës “Hapni dritaret” në përbërje: Vladimir Llazovski, Margarita Gulevska, Radmilla Stojkovska-Aleksova, Ollga Samarxhiq-Jankova, Magdalena Dimkova-Velevska, Marija Velinovska dhe Aleksandra Spasovska.

Të dhënat i përpunoi Ollga Samarxhiq-Jankova

Në analizën e gjetjeve dhe formulimin e përfundimeve dhe rekomandimet merrnin pjesë të gjithë anëtarët e ekipit hulumtues.

Autorët e raportit janë: Vladimir Llazovski dhe Margarita Gulevska

Daniela Graoroska nga MASH dhe Marija Simonova nga BZHA kontribuan në zhvillimin e metodologjisë, pyetësorit anketues dhe materialet e përdorura shoqëruese, nëpërmjet konsultimeve, këshillave dhe informacioneve.

Natasha Bulevska dhe Lepa Jakovlevska nga USAID-Maqedoni e ndoqën rrjedhën e përgjithshme dhe ishin të konsultuara në fazat kyçe të hulumtimit.

Zbatimi i hulumtimit ishte i mbështetur nga MASH dhe BZHA, që kontribuoi për pjesëmarrjen e lartë të shkollave të mesme. Gjithashtu, MASH i siguroi informacionet për kontakt të shkollave të mesme në Maqedoni.

2. GJETJE


Karakteristika të mostrës

Pyetësi anketues ishte dorëzuar tek të gjitha 96 shkollat e mesme publike në vend, me përjashtim të atyre të veçantave. Prej tyre, 72 (75%) morrën pjesë në anketë.

Shembulli hulumtues ka nivel jashtëzakonisht të lartë të përfaqësimit, që mund të ilustruhet nëpërmjet parametrave të mëtejshme:

Në 72 shkollat që siguruan të dhëna mësojnë gjithësej 58.671 nxënës, që paraqet 69% nga nxënësit e regjistruar gjithsej 85,006 nxënës në shkollat e mesme në fillimin e vitit shkollor 2013/14 (burimi: [Enti shtetëror për statistikë](#)).

Fig. 1: Struktura e shkollave sipas gjuhës së mësim



Përgjigje dorëzuan shkolla që kryejnë mësim në gjuhën maqedonase dhe në shqip, si edhe shkolla dygjuhëshe dhe tregjuhëshe.

Fig. 2: Struktura e shkollave sipas gjuhës së mësim

Gjuha e mësim	Numri i shkollave të mesme		
	Gjithsej	U përgjigjën	%
Maqedonisht	49	46	93,9%
Shqip	4	2	50%
Maqedonisht dhe shqip	29	14	48,3%
Maqedonisht dhe turqisht	4	3	75%
Maqedonisht dhe serbisht	1	0	0%
Maqedonisht, shqip dhe turqisht	9	7	77,8%
Gjithsej:	96	72	75%

Në anketë morrën pjesë shkolla të mesme të lokalizuara në qytet dhe në fshat:

Fig. 3: Struktura e shkollave sipas llojit të vendit të populluar


Lloji i vendit të populluar	Numri i shkollave të mesme		
	Gjithsej	U përgjigjën	%
Qytet	89	67	75,3%
Fshat	7	5	71,4%
Gjithsej:	96	72	75%

Gjithashtu, shembulli është reprezentativ në kuptim të përfaqësimit rajonal, duke pasur parasysh faktin se në anketë morrën pjesë shkollat nga të gjitha 8 planet rajonale në Maqedoni, të përcaktuara me Ligjin për zhvillim të balancuar rajonal.

Përfaqësimi i nxënësve me NVA

Në vitin shkollor 2013/14, nxënës me NVA janë të përfshirë në 62,5% nga shkollat e mesme të rregullta në Maqedoni: nga gjithsej 72 shkolla që kanë dorëzuar përgjigje ndaj pyetjes, në 45 ka të paktën një nxënës me NVA.


Fig. 4: Përfaqësimi i nxënësve me NVA në shkollat e mesme të rregullta



Në 45 shkollat që janë përgjigjur me konfirmim, mësim ndjekin 326 nxënës me NVA


Mesatarisht, në ndonjë shkollë të mesme ka nga 4,5 nxënës me NVA, që paraqet 0,6% nga numri i përgjithshëm i nxënësve në to. Përderisa merren parasysh vetëm shkollat që janë përgjigjur se kanë nxënës me NVA, mesatarja është 7,2 nxënës me NVA, ose 0,9% nga numri i përgjithshëm i nxënësve.

Fig. 5: Numri mesatar i nxënësve me NVA në shkollat e mesme



Në lidhje me strukturën gjinore të nxënësve me NVA, 212 janë meshkuj dhe 114 janë femra (65% dhe 35%, përkatësisht). Përfaqësimi i nxënësve me NVA me gjini mashkullore është më i lartë në lidhje me strukturën gjinore të të gjithë nxënësve - 65% përkundër 56% nxënës meshkuj.


Fig. 6: Struktura gjinore e të gjithë nxënësve dhe e nxënësve me NVA



Sipas llojit të pengesës, më shumë nxënës me NVA përballen me pengesa në zhvillimin psikik - 148, pas së cilës pasojnë nxënës me invaliditet trupor - 58 dhe nxënës me multihendikep - 46. Në shkollat ka 36 nxënës me NVA që kanë lloje të tjera, të pengesave të papërmendura në opsionet e ofruara, nga të cilat më shpesh janë të përmendura: vështirësi në të mësuarin, vështirësi gjatë të lexuarit (duke përfshirë disleksia), të sëmurë kronikë etj.

Këtë pyetje e kanë përgjigjur vetëm 45 shkolla që kanë raportuar nxënës me NVA.

Fig. 7: Struktura e nxënësve me NVA në shkollat e mesme sipas llojit të pengesës



Shkollat më shpesh e përcaktojnë numrin e nxënësve me NVA nëpërmjet informacioneve, me shkrim ose gojë, të fituara nga prindërit (70,4%). Në pak më shumë se një e katërta e rasteve (27,8%), vërtetimi është mbi bazë të vlerësimit nga ekipi profesional dhe mësuesit.

Fig. 8: Si e vërtetojnë shkollat numrin e nxënësve me NVA


Përgjigje	Numri i përgjigjeve	%
Prindërit kanë dorëzuar për shqyrtim dokument nga institucion kompetent për nevojat e veçanta arsimore të nxënësit	39	36,1%
Prindërit me gojë e kanë njoftuar shkollën për nevojat e veçanta arsimore të nxënësit	37	34,3%
Nëpërmjet vlerësimit të ekipit profesional të mësuesëve	30	27,8%
Të tjera	2	1,8%
Gjithsej:	108	100%

Të dyja shkollat që janë përgjigjur se e vërtetojnë në mënyrë tjetër, më të ndryshme nga ato që janë afruar paraprakisht, numrin e nxënësve me NVA kanë përmendur se: fitojnë informacione nga ekipet profesionale të shkollave fillore nga ku vijnë nxënësit e tyre, pra i njohim më mirë nxënësit e tyre nëpërmjet vizitave nëpër familje.

Përgjigje ndaj kësaj pyetje kanë dhënë 63 shkolla që kishin mundësi të përmendin më shumë se një opsion: 9 shkolla nuk janë përgjigjur.

Vetëm 4 nga shkollat (5,6%) në të kaluarën janë gjendur në situatë të mos mund të pranojnë nxënës me NVA:

Fig 9: A kanë mundur shkollat të mos pranojnë nxënës me NVA në të kaluarën



Tre nga katër shkollat kanë përmendur se mospatja e kushteve të përshtatshme fizike, ajo është mosqasja fizike në ndërtesën e shkollës ka qënë arsyeja për pamundësinë që të pranohet nxënës me NVA; më saktësisht me vështirësi gjatë lëvizjes. Në një rast shkaku ka qënë

dokumentacioni i papërshtatshëm i dorëzuar për nxënësin me NVA gjatë regjistrimit: “nxënësi kishte dokument që është person me nevoja të veçanta, por në të nuk kishte mendim se mund ta vazhdojë arsimin në arsimin e rregullt”.

Një shkollë që është përgjigjur se nuk është përballur me situatë të tillë ka përmendur në mënyrë plotësuese se “i pranojmë këta nxënës vetëm nga humaniteti, por nuk kemi kushte”.


Inkluziviteti i shkollës

Inkluziviteti i shkollave të mesme ishte hulumtuar nëpërmjet tre elementeve kryesore:

- qasja fizike dhe kushtet,
- përdorimi i mbështetjes profesionale defektologjike gjatë punës me nxënës me NVA, dhe
- iniciativat dhe masat inkluzive që shkolla i ka realizuar në të kaluarën.

Në lidhje me lehtësimin e qasjes fizike për nxënësit me NVA, masa e aplikuar më shpesh është vendosja e platformës së pjerrët qasëse për hyrje, me çka disponojnë 32 shkolla (44,4%). Nga ana tjetër, 24 shkolla (33,3%) nuk kanë ndërmarrë asnjë masë, dhe vetëm një shkollë (1,4%) disponon me ashensor të brendshëm përkundër faktit se numri më i madh i shkollave të mesme janë në ndërtesa me më shumë se një kat.

Fig. 10: Masa të shkollave për lehtësim të qasjes fizike




Katër shkolla kanë u kanë mundësuar nxënësve të tyre me pengesa të mësojnë vetëm në klasa në katin përdhes. Një shkollë nxit mbështetje plotësuese nga mësuesit dhe shokët e klasës, dhe një tjetër bashkëpunon me shkollën lokale të veçantë që të sigurojë mbështetje profesionale dhe këshilla për mësuesit që punojnë me nxënës me NVA.

Gjatë përgjigjes së kësaj pyetje, shkollat mund të shënonin më shumë se një opion, 11 shkolla (15.3%) nuk janë përgjigjur.


Shumicë e madhe e shkollave të mesme nuk fitojnë mbështetje profesionale nga defektolog në cilëndo mënyrë: gjithsej 60 shkolla ose 83,3% nga ato që merrnin pjesë në hulumtim. Tre shkolla punësojnë defektolog me orar të plotë pune, nga të cilat dy janë në të njëjtën komunë (Strumicë).

Fig. 11: Defektologë në shkollat e mesme



Në pikëpamje të iniciativave në tre vitet paraprake, vetëm 7 shkolla (9,7%) kanë bërë mundime potësuese që ta përmirësojnë përfshirjen e nxënësve me NVA. Pjesë e konsiderueshme më e madhe e shkollave - 55 (76,4%) nuk kanë ndërmarrë hapa të tilla.

Fig. 12: Iniciativa inkluzive në tre vitet paraprake



Shembujt e përmendur për masat e ndërmarra dhe iniciativat përfshijnë: përmirësim të qasjes fizike në shkollë, bashkëpunim me organizata qytetare në projekte të përbashkëta inkluzive, trajnime për mësuesit dhe ekipet profesionale për përmirësim të kapacitetit të tyre për punë me nxënës me NVA, pjesëmarrje në zhvillimin e planeve lokale për inkluzion në bashkëpunim me vetëqeverisjen lokale etj.

Shkollat i vlerësojnë pozitivisht rezultatet nga puna me nxënës me NVA: duke i përmbledhur përvojat vetjake, thuajse gjysma e shkollave konsiderojnë se nxënësit me NVA fitohen me dijet e nevojshme dhe arrijnë sukses ta përfundojnë arsimin e mesëm. Duket se shkollat, të marra në përgjithësi, e mbështetin inkluzionin duke pasur parasysh faktin se nuk janë fituar përgjigje se për nxënësit me NVA do të ishte më mirë të jenë të përfshirë në arsimin e veçantë.


Fig. 13: Përvojat e shkollave në punën me nxënës me NVA

Përgjigje	Numri i përgjigjeve	%
Pjesa më e madhe e nxënësve me NVA fitohen me dijet themelore të parashikuara dhe e përfundojnë arsimin e mesëm të rregullt	34	47,2%
Nxënësit me NVA e përfundojnë arsimin e mesëm të rregullt, por pjesa më e madhe e tyre nuk i fitojnë dijet e parashikuara themelore	14	19,5%
Nxënësit me NVA nuk mund ta ndjekin mësimin dhe e ndërpresin arsimin e mesëm të rregullt	0	0%
Shkolla u sugjeron prindërve se për fëmijët e tyre ekzistojnë mundësi dhe kushte më të mira në shkollat e veçanta, kështu që në shkollën tonë thuajse asnjëherë nuk regjistrohen nxënës me NVA	0	0%
Nuk kemi patur përvojë të tillë deri tani	18	25%
Nuk u përgjigjën	6	8,3%
Gjithsej:	72	100%

Nxënësit me NVA dhe aplikimi i kompjuterave në mësim


Në gjysmën e shkollave (50%) e nxënësve me NVA përdorin kompjuter në procesin mësimor, në mënyrë të barabartë me shokët e tjerë të klasës. Megjithatë, një e gjashta e shkollave (16,7%) kanë parë se disa (një pjesë ose të gjithë) nxënësit me NVA nuk mund të përdorin kompjuter:

Fig. 14: Nxënësit me NVA dhe përdorimi i kompjuterit në mësim



Përderisa, merren parasysh vetëm përgjigjet e 45 shkollave që kanë sipas përgjigjes, përvojë të drejtpërdrejtë, një e katërta e shkollave (25%) konsiderojnë se vetëm një pjesë e nxënësve me NVA mund të përdorin kompjuter ose nuk mund ta përdorin aspak. (Gjatë këtij shqyrtimi janë përjashtuar 19 shkolla që kanë përmendur se nuk kanë nxënës me NVA dhe 5 shkolla që nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje.)


Fig. 15: Nxënësit me NVA dhe përdorimi i kompjuterit nëpër shkolla me përvojë të drejtpërdrejtë



Gjatë saj, vështirësitë e nxënësve me NVA të përmendura më shpesh janë: vështirësi të nxënësve me shikim të dëmtuar për ta përdorur kompjuterin për shkak të madhësisë së papërshtatshme të monitorit dhe tastierës së kompjuterave shkollorë, pamundësia të përdoren mausi (miu) dhe tastiera për shkak të mungesës së motorikës fine, mungesë të përshtatjeve softuerike, mungesë të softuerit arsimor të përshtatur për nxënësit me NVA etj.

Shumica e madhe e shkollave konsiderojnë se nxënësit me NVA mund të kenë dobi nga përdorimi i kompjuterit në mësim.

Fig. 16: A mund të kenë nxënësit me NVA dobi nga përdorimi i kompjuterit në mësim




Shkollat kanë përmendur përfitime të numërta të mundshme nga përdorimi i kompjuterit në mësim nga ana e nxënësve me NVA: të mësuar më të lehtë të përmbajtjeve mësimore, zhvillim më të shpejtë të funksioneve motorike dhe mendore, shkrim të lehtësuar nga ana e nxënësve që kanë vështirësi motorike në duar, zhvillim të kreativitetit, aftësitë komunikuese dhe sociale, zhvillim të memories, nxitje shpirtit hulumtues dhe interesit për të mësuar, qasje të lehtësuar për informacione dhe materiale për të mësuar etj. Katër shkolla (5,6%) konsiderojnë se nxënësit me NVA përdorin kompjuter që ta risin vetëbesimin e tyre dhe ndjenjën e barazisë me nxënësit e tjerë.

Gjithashtu gjashtë shkolla (8,3%) kanë cekur se zbatimi i pajisjeve asistuese dhe softuerit përkatës dhe aplikimeve arsimore që veçanërisht do ta nxisin përfshirjen aktive të nxënësve me NVA në mësim. Një shkollë (1,4%) ka theksuar se në vend mungon teknologji dhe softuer për nxënësit me NVA të përshtatura sipas nevojave, mundësive dhe interesave të tyre”.

Konfirmim për konstatimin e fundit është edhe fakti që vetëm në dy shkolla (2,8%) nxënësit me NVA përdorin ndonjë pajisje kompjuterike asistuese ose përshtatje softuerike.

Fig. 17: Aplikimi i pajisjeve asistuese ose përshtatjeve softuerike



Nxënësit me NVA përdorin: tastierë me butona të mëdha dhe pështatje të mausit (miut) në njëren shkollë dhe trakboll në tjetrën.

Nevoja prioritare dhe rekomandime të shkollave

Që ta përparojnë punën me nxënës me NVA shkollat së pari konsiderojnë se u janë të nevojshme trajnime të shërbimit profesional dhe të mësuesve: trajnimi për shërbimin profesional është prioriteti i parë për 22 shkolla (30,5%), dhe trajnimi për mësuesit për 16 shkolla (22,2%). Pason angazhimi i defektologut: 13 shkolla (18,1%) dëshirojnë të angazhojnë defektolog mobil, sipas shembullit të arsimit fillor, derisa 11 (15,3%) kanë nevojë për punësim të defektologut me orar të plotë pune. Për 5 shkolla (6,9%), përmirësimi i qasjes fizike në objektin shkollor është më prioritare.

Gjatë përgjigjes së kësaj pyetjeje shkollave u ishin ofruar paraprakisht opsione që ata i rendisnin sipas prioritetit nga 1 deri në 3. Shkollat kishin mundësi të përmendin nevoja plotësuese, jashtë nga ato që ishin ofruar paraprakisht, që e shfrytëzoi një shkollë duke e cekur këtë përgjigje: “Përgatitje të programeve të përshtatura për nxënësit me NVA nga ana e BZHA dhe QAPT, ndryshime në rregulloren ligjore dhe përmirësim të qasjes fizike”.

Gjithsej 8 (11,1%) të shkollave konsiderojnë se puna me nxënës me NVA nuk është midis prioriteteve të tyre

Fig. 18: Nevoja prioritare për shkollat për përparim të punës me nxënësit me NVA

Përgjigje	Prioritet 1.		Prioritet 2.		Prioritet 3.	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Punësim të defektologut	11	15,3%	2	2,8%	3	4,2%
Angazhim të defektologut mobil	13	18,1%	12	16,7%	10	13,9%
Trajnim të mësuesëve për punë me nxënës me NVA	16	22,2%	27	37,4%	15	20,8%
Trajnim të stafit profesional për identifikim të nxënësve me NVA dhe dhënie të mbështetjes të mësuesëve për punë me ta	22	30,5%	12	16,7%	18	25%
Përmirësimin e qasjes fizike në shkollë	5	6,9%	8	11,1%	9	12,5%
Përparimin e punës me nxënës me NVA nuk është prioriteti ynë	4	5,6%	2	2,8%	2	2,8%

Të tjera (të përmendura më lart)	1	1,4%	0	-	0	-
Nuk u përgjigjën	0	-	9	12,5%	15	20,8%
Gjithsej:	72	100%	72	100%	72	100%

37 shkolla (51,4%) dhanë informacione plotësuese, komentare dhe rekomandime në lidhje me punën me nxënës me NVA.

Dhjetë prej tyre kërkuan trajnime plotësuese dhe përfundim të kapaciteteve të mësuesve dhe të ekipit profesional për punë me nxënës me NVA. Dy fusha kryesore në të cilat është përmendur se janë të nevojshme për përmirësim janë identifikimi i nxënësve me NVA dhe përshtatja e planeve dhe programeve mësimore ndaj nevojave të tyre individuale. Një nga shkollat ka përmendur: *“Kudri mësimor dhe shërbimet profesionale po përballen me probleme në pjesën e përpunimit të planeve të adaptuara mësimore për punë me nxënës me NVA, me qëllim që synimet e vendosura të mund t’i kuptojnë më lehtë dhe më shpejt”* Shkollë tjetër konsideronte se është e nevojshme *“të aftësohet ekip profesional për detektim të rregullt të fëmijëve me NVA”*.

Për pesë shkolla është primare të kompletohen shërbimet profesionale me profilet e nevojshme, në rradhë të parë defektolog, që do të mund ta përmirësonte mbështetjen që nxënësit me NVA e fitojnë në shkollë: *“Që të mundësohet zhvillim i plotë në punën edukuese-arsimore, si edhe zhvillim komplet psikologjik të nxënësve me NVA, është i domosdoshëm person profesional-defektolog, që do të punojë dhe do të japë ndihmë profesionale për mësuesit.”*

Tre shkolla janë drejtuar në mbështetjen e nevojshme të nxënësve me NVA gjatë testimit ekstern dhe provimeve të maturës: *“Për provimet eksterne dhe për provimet e maturës na është i nevojshëm kompjuter me alfabet braj për nxënësit me shikim të dëmtuar, dhe nxënësit me autizëm duhet të fitojnë mbështetje nga defektolog.”*

Pesë shkolla konsiderojnë se është e nevojshme të përmirësohet qasja ndërtesës shkollore dhe pajisja me *“mjete dhe pajisje ndihmëse të veçanta”*. Dy shkolla ndjejnë nevojë për ndërtim të ashensorit.

Pesë shkolla rekomandojnë se është e nevojshme të përmirësohet bashkëpunim me prindërit, veçanërisht në pjesën e identifikimit dhe *“kategorizimin e nxënësve me NVA”*.

Dy shkolla kanë cekur se kanë përvoja jashtëzakonisht pozitive në fushën e inkluzionit të nxënësve me NVA: *“Dhjetra nxënës e kanë përfunduar në mënyrë të suksesshme arsimin e mesëm. Bëhet fjalë për fëmijë me invaliditet trupor, dëmtim të shikimit dhe dëgjimit, disgrafi, disleksia dhe sindrom hiperaktiv. Pjesë e tyre përfunduan arsimin e lartë, janë të përfshirë në shoqëri dhe kanë familje.”*

Katër shkolla, kanë shprehur rezerva në pikëpamje të përfshirjes së nxënësve me NVA në arsimin e rregullt të mesëm: *“Nxënësit me NVA nuk ndjehen rehat në klasat paralele. Të aktivizohet paralele e veçantë për ta që do të punojë sipas planeve dhe programeve të veçanta, të pranueshme për ta.”* Një nga shkollat konsideron se profilet arsimore dhe profesionet që mësohen tek ta nuk janë të përshtatshme për nxënës me NVA deri dhe sjellin rrezik për lëndim: *“Në mësimin praktik përdoret energji elektrike dhe makineri profesionale, të mundshme janë edhe lëndime”*.

3. PËRFUNDIME

1. Në arsimin e mesëm të rregullt janë të përfshirë nxënës me lloje të ndryshme të pengesave, që kanë nevoja të veçanta individuale për përshtatje dhe mbështetje për përfshirje në procesin mësimor dhe në mjedisin shkollor.

2. Nuk ekziston qasje sistemike ndaj identifikimit dhe ndjekjes së nxënësve me NVA në arsimin e mesëm. Pothuajse një e treta e shkollave kryesisht mbështeten në vlerësimin e ekipit profesional dhe të mësuesëve gjatë përcaktimit të nxënësve me NVA, që tregojnë në komunikim të pamjaftueshëm me prindërit dhe mungesë komunikimi me nivelin paraprak të arsimit - fillor.

3. Qasja e pamjaftueshme fizike në ndërtesat e shkollave bëhet sfidë në pikëpamje të përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. Është ilustrative se tre shkolla kanë deklaruar se paarrshmëria në objektin shkollor ka qënë shkaku i drejtpërdrejtë për pamundësinë që të pranohet nxënës me pengesë fizike.

4. Ekipet profesionale shkollore më shpesh nuk përfshijnë defektolog ose ndonjë profil tjetër që do të mund të sigurojë mbështetje profesionale për nxënësit me NVA dhe për ekipin shkollor që punon me ta. Ajo i kufizon mundësitë për sigurim të arsimit kualitativ për nxënësit me NVA dhe kontribuon për marrëdhënien e përcaktuar inerte të pjesës më të madhe të shkollave në pikëpamje të ndërmarrjes së masave për përmirësim të inkluzivitetit të tyre personal.

5. Më shumë se gjysma e shkollave të mesme që kanë përvojë në punën me nxënës me NVA konsiderojnë se ofrojnë mundësi të mira arsimore për ta. Përballë vështirësive, shkollat mundësojnë që pjesa më e madhe e nxënësve me NVA të fitohen me dijet themelore të parashikuara dhe ta përfundojnë arsimin e mesëm. Ajo paraqet bazë të mirë për përmirësimin e mëtejshëm të inkluzivitetit të tyre.

6. Një e katërta e nxënësve me NVA përballen me vështirësi ose nuk mund ta përdorin pajisjen standarde kompjuterike dhe softuerin nëpër shkolla. Shkollave u mungon pajisje asistuese dhe përshtatje softuerike dhe aplikime të përshtatura për aftësitë e nxënësve me NVA.

7. Shumicë e madhe e shkollave të mesme konsiderojnë se nxënësit me NVA mund të kenë përfitime nga përdorimi i kompjuterit në mësim. Përkundër asaj, vetëm dy shkolla përdorin ndonjë pajisje asistuese ose përshtatje softuerike që tu mundësojnë ose lehtësojnë nxënësve me NVA të përdorin kompjuter.

8. Nevoja prioritare për shkollat janë trajnime për mësuesit dhe për ekipet profesionale për punë me nxënës me NVA. Ku, veçanërisht janë theksuar fushat e mëtejshme: identifikimi i nxënësve me NVA dhe përshtatja e planeve dhe programeve mësimore ndaj nevojave të tyre individuale.

9. Kryerja e testimit ekstern dhe provimi i maturës nuk është i përshtatur ndaj nevojave specifike të nxënësve me NVA. Ajo tregon se nxënësit me NVA nuk kanë mundësi të barabarta me nxënësit e tjerë gjatë dhënies së provimeve eksternë dhe provimeve të maturës.

4. REKOMANDIME

1. Është e nevojshme të përcaktohet qasja sistemike për identifikim dhe ndjekje të nxënësve me NVA në arsimin e mesëm. Ajo përfshin akte nënligjore, procedura, rregullore etj., që mes të tjerave, do ta nxisin dhe mundësojnë bashkëpunimin midis shkollave të mesme dhe prindërve, si edhe shkëmbimin e informacioneve me shkollat themelore nga ku vijnë nxënësit me NVA në arsimin e mesëm.

2. Duhet të përmirësohet qasja fizike në shkollat e mesme. Standardet për qasje duhet të jenë reptësisht të zbatuara gjatë ndërtimit të ndërtesave të reja shkollore ose rikonstruksion të shkollave ekzistuese.

3. Ekipet shkollore të shkollave të mesme duhet të përfshijnë defektologë. Modelin e defektologut mobil (të angazhuar në më shumë shkolla në të njëjtën kohë) i zbatuar në arsimin fillor mund të jetë zgjidhje e mirë fillestare që të tejkalohet mangësia e mjeteve për personelin e plotë të ekipeve profesionale në të gjitha shkollat.

4. Teknologjia asistuese, duke përfshirë pajisje asistuese, përshtatje softuerike dhe aplikacione qasëse arsimore, duhet të zbatohet në shkollat e mesme. Ajo në masë të madhe mund t'i përmirësojë mundësitë arsimore dhe pjesëmarrjen aktive të nxënësve me NVA në mësim. Duhet të shqyrtohen mundësitë për futje sistemike të teknologjisë asistuese në shkollat e mesme.

5. Duhet të intensifikohen mundimet për sigurim të trajnimeve për mësuesit dhe ekipet profesionale të shkollave të mesme për punë me nxënës me NVA. Fusha prioritare për trajnim janë: identifikim të nxënësve me NVA dhe përshtatje të planeve dhe programeve mësimore ndaj nevojave të tyre individuale.

Në mënyrë plotësuese. Mësuesit dhe ekipet profesionale duhet të fitojnë trajnime që do të mundësojnë ta përdorin teknologjinë bashkëkohore informativo-komunikuese, duke e përfshirë asistuesen, në përshtatjen e planeve dhe përmbajteve mësimore.

6. Duhet të parashikohen masa që do tu mundësojnë nxënësve me NVA mundësi të barabarta gjatë dhënies së provimeve eksterne dhe provimeve të maturës. Këto provime duhet t'i marrin parasysh planet individuale arsimore për nxënësit me NVA dhe mbështetje, sipas nevojave, gjatë përgatitjes së provimit (për shembull, nga defektolog) dhe gjatë vetë dhënies së provimit (për shembull, zbatimi i teknologjisë asistuese në vend të përdorimit të kompjuterit dhe softuerit standard).

Shtojca 1: PYETËSOR ANKETUES

PYETËSOR **për përcaktimin e nevojave nga teknologjia asistuese** **në shkollat e mesme**

Ky pyetësor anketues ka për qëllim të përcaktohet nevoja nga aplikimi i teknologjisë asistuese gjatë punës me nxënës me nevoja të veçanta arsimore në shkollat e mesme të rregullta. Teknologjia asistuese përfshin pajisje, mjete ndihmëse dhe përshtatje të pajisjeve standarde kompjuterike, me të cilat mundësohet dhe lehtësohet përdorimi i kompjuterëve nga ana e personave me pengesa.

Pyetjet e përmendura në të sillen për vitin shkollor 2013/14. Për përgjigje do të jenë të nevojshme rreth njëzet minuta.

Ky pyetësor anketues është pjesë e Projektit të USAID për e-arsim (arsim elektronik) të disponueshëm, të zbatuar nga shoqata “Hapni dritaret”. Realizimi i hulumtimit është mbështetur nga Ministria e arsimit dhe shkencës (kopja e shkresës është në vijim).

Rezultatet nga hulumtimi do të shërbejnë që të zgjidhen dy shkolla të mesme që do të jenë të pajisura me teknologji asistuese dhe do të jenë të trajnuara për zbatim në punën me nxënës me nevoja të veçanta arsimore.

Anketa do të jetë e zbatuar në të gjitha shkollat e mesme në Maqedoni. Përgjigjet tuaja objektive, të sakta dhe në kohë do të kontribuojnë të tejkalohet mungesa e tanishme e të dhënave për përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në arsimin e mesëm të rregullt.

Ju lutemi pyetësorët e plotësuar t’i dërgoni tek shoqata e qytetarëve “Hapni Dritaret” jo më vonë se 08.11.2013. për dërgim të përgjigjeve përdorni informacionet për kontakt të përmendura në letrën shoqëruese.

Ju faleminderit për kohën e veçuar dhe për bashkëpunimin.

I. INFORMACIONE PËR KONTAKT

Shkolla e mesme: _____

Vendi i populluar: _____ **Komuna:** _____

Gjuha e mësimdhënies në shkollë (qarkoni përkatësisht):

- | | |
|---|---------------------------------------|
| <input type="checkbox"/> gjuhë maqedonase | <input type="checkbox"/> gjuhë shqipe |
| <input type="checkbox"/> gjuhë turke | <input type="checkbox"/> gjuhë serbe |

Emri dhe mbiemri i plotësuesit:

Pozita e punës në shkollë:

Informacione - kontakti për plotësuesin:

tel.: _____ mob: _____ e-mail: _____

Data e plotësimit:

Nënshkrimi dhe vula:

II. PYETJE PËR NEVOJËN E TEKNOLOGJISË ASISTUESE

1. Sa nxënës e vizitojnë gjithësej shkollën Tuaj?

Numri i nxënësve	Meshkuj	Femra	Gjithsej

2. Sa nxënës me nevoja të veçanta arsimore e vizitojnë shkollën Tuaj?

Numri i nxënësve	Meshkuj	Femra	Gjithsej

3. Sa nxënës me nevoja të veçanta arsimore përballen me llojet e pengesave të përmendura?

- nxënës me pengesa në zhvillimin psikik: _____
 - nxënës me invaliditet trupor: _____
(nxënës që kanë vështirësi gjatë lëvizjes së duarve, këmbëve ose të gjithë trupit, nxënës që kanë paralizë cerebrale, nxënës që përdorin pajisje ndihmëse si për shembull karrige me rrota, paterica etj.),
 - nxënës me shikim të dëmtuar: _____
(të shkallës më të rëndë dhe që e pengojnë nxënësin ta ndjekë mësimin)
 - nxënës me dëgjim të dëmtuar: _____
(të shkallës më të rëndë dhe që e pengojnë nxënësin ta ndjekë mësimin)
 - nxënës me multihendikep: _____
(invaliditet i kombinuar trupor dhe pengesa në zhvillimin psikik)
 - nxënës me autizëm: _____
(spektri autik i çrregullimeve)
 - të tjera (Ju lutemi përmendni): _____
-
-

4. Në cilën mënyrë shkolla juaj përcakton se cilët nxënës janë me nevoja të veçanta arsimore? Mund të shënoni më shumë se një opsion:

- prindërit kanë dorëzuar për shqyrtim në shkollë dokument nga institucion kompetent për nevojat e veçanta arsimore të nxënësit
 - prindërit e kanë njoftuar me gojë shkollën për nevojat e veçanta arsimore të nxënësit
 - nëpërmjet vlerësimit të ekipit profesional dhe mësuesëve
 - të tjera (Ju lutemi përmendni): _____
-
-
-

5. A është gjendur shkolla juaj deri tani në situatë të tillë të mos mund të pranojë nxënës me nevoja të veçanta arsimore?

po

jo

Përderisa po, Ju lutemi shpjegoni:

6. Çfarë masash ka ndërmarrë shkolla Juaj deri tani që ta lehtësojë qasjen fizike për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore? Mund të shënoni më shumë se një opsion:

qasje e lehtësuar në ndërtesën e shkollës (platformë e pjerrët qasëse, ashensor në derën hyrëse etj.)

janë përshtatur hapësirat e brendshme në shkollë (klasat, tualetet etj.)

është ndërtuar ashensor i brendshëm

nuk janë ndërmarrë masa të veçanta për lehtësim të qasjes së nxënësve me nevoja të veçanta

të tjera (Ju lutemi përmendni):

7. A fiton mbështetje shkolla Juaj nga person profesional - defektolog në punën me nxënës me nevoja të veçanta?

po, në shkollë punon defektolog me orar të plotë pune

po, në shkollë punon defektolog “mobil” (i angazhuar në më shumë shkolla)

po, në shkollë punon defektolog - vullnetar

jo

8. Në mënyrë të përgjithshme, cili nga opsionet e përmendura e shpreh më qartë përvojën e shkollës Tuaj në punën me nxënës me nevoja të veçanta arsimore?

pjesa më e madhe e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore fitohen me dijet e parashikuara themelore dhe e përfundojnë arsimin e mesëm të rregullt

nxënësit me nevoja të veçanta arsimore e përfundojnë arsimin e mesëm të rregullt, por pjesa më e madhe e tyre nuk i fitojnë dijet e parashikuara themelore

nxënësit me nevoja të veçanta arsimore nuk mund ta ndjekin mësimin dhe e ndërpresin arsimin e mesëm të rregullt

shkolla u tregon prindërve se për fëmijët e tyre ekzistojnë mundësi dhe kushte më të mira në shkollat e veçanta, kështu që në shkollën tonë thuhet asnjëherë nuk regjistrohen nxënës me nevoja të veçanta arsimore

nuk kemi patur përvojë të tillë deri tani

9. A përdorin nxënësit tuaj me nevoja të veçanta arsimore kompjuter në mësim?

- po, si edhe nxënësit e tjerë
- numër i kufizuar i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore përdorin kompjuter
- jo, nxënësit me nevoja të veçanta arsimore nuk përdorin kompjuter
- nuk kemi nxënës me nevoja të veçanta arsimore

Ju lutemi përmendni me gfarë vështirësish përballen nxënësit me nevoja të veçanta arsimore që nuk përdorin kompjuter në mësim?

10. A mendoni se nxënësit me nevoja të veçanta arsimore mund të kenë dobi nga përdorimi i kompjuterit në mësim?

- po
- jo

Ju lutemi shpjegoni (për shembull, cila do të ishte dobia për ta nga përdorimi i kompjuterit në mësim ose, pse mendoni se ata nuk do të kishin dobi).

11. A përdor ndonjë nga nxënësit Tuaj me nevoja të veçanta arsimore pajisje asistuese kompjuterike (tastierë me butona të mëdha, trakboll, xhojstik etj.) ose përshtatje softuerike (përshtatje të mausit (miut), të ekranit etj.) gjatë punës me kompjuter?

- po
- jo
- nuk kemi nxënës me nevoja të veçanta arsimore

Nëse po, Ju lutemi përmendni:

12. Përmendni cilat janë tre nevojat Tuaja prioritare për përparimin në punën me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore? Me 1 shënoni prioritetin e parë; me 2 të dytin dhe me 3 - të tretin

_____ punësim të defektologut

_____ angazhim të defektologut mobil

_____ trajnim të mësuesëve për punë me nxënës me nevoja të veçanta arsimore

_____ trajnim të ekipit profesional për identifikim të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe dhënie të mbështetjes së mësuesëve për punën me ta

_____ përmirësim të qasjes fizike në objektin shkollor

_____ përparimi i punës me nxënës me nevoja të veçanta arsimore nuk është prioriteti ynë

_____ të tjera (Ju lutemi përmendni): _____

13. A ka marrë pjesë shkolla Juaj në tre vitet e fundit shkollore, në iniciativa ose projekte për përmirësim të përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta?

po jo

Nëse po, Ju lutemi përshkruani:

14. Informacione plotësuese, përvoja ose propozime në lidhje me punën me nxënës me nevoja të veçanta arsimore të cilat do të dëshironit t'i ndani:

Shtojca 2: LISTA E SHKOLLAVE TË MESME TË PËRFSHIRA

Nr.	Emri i shkollës	Vendi i populluar	Komuna	Gjuha e mësimdhënies
1	ASUC "Boro Petrushevski"	Shkup	Gazi Baba	maqedonisht, shqip
2	SOU "Mavrovë - Rostushë"	Fsh. Rostushë	Mavrovë dhe Rostushë	maqedonisht
3	SOU "Josif Josifovski"	Gjevgjeli	Gjevgjeli	maqedonisht
4	"Pero Nakov"	Kumanovë	Kumanovë	maqedonisht, shqip
5	SOEPTU "Kuzman Josifovski Pitu"	Prilep	Prilep	maqedonisht
6	SOU "Ljupço Santov"	Kočani	Kočani	maqedonisht
7	DSULUD "Lazar Liçenoski"	Shkup	Qendër	maqedonisht
8	SOZU "Kuzman Shapkarev"	Manastir	Manastir	maqedonisht
9	DMBUC "Ilija Nikollovski Luj"	Shkup	Qendër	maqedonisht, shqip
10	SOU "Gosho Vikentiev"	Kočani	Kočani	maqedonisht
11	SEOU "Gostivar"	Gostivar	Gostivar	maqedonisht, shqip, turqisht
12	DMUC "Sergej Mihajlov"	Shtip	Shtip	maqedonisht
13	"Kiro Spanxhov - Brko"	Kavadarci	Kavadarci	maqedonisht
14	SETUGS "Mihailo Pupin"	Shkup	Gazi Baba	maqedonisht
15	"Jane Sandanski"	Strumicë	Strumicë	maqedonisht
16	SOU "Car Samoil"	Resnjë	Resnjë	maqedonisht, shqip, turqisht
17	OSU "Jovçe Tesliçkov"	Veles	Veles	maqedonisht
18	SOU "Nikolla Karev"	Strumicë	Strumicë	maqedonisht
19	SOU "Sh. Naum Ohridski"	M. Brod	M. Brod	maqedonisht
20	OSTU "Gostivar"	Gostivar	Gostivar	maqedonisht, shqip, turqisht
21	Gjimnazi "Josip Broz Tito"	Manastir	Manastir	maqedonisht
22	SOU "Kole Nehtenin"	Shtip	Shtip	maqedonisht
23	SUGS "Koço Racin"	Shkup	Gj. Petrov	maqedonisht
24	SSOU "Mosha Pijade"	Tetovë	Tetovë	maqedonisht, shqip
25	"Riste Risteski Riçko"	Prilep	Prilep	maqedonisht
26	"Naum Naumovski Borçe"	Krushevë	Krushevë	maqedonisht
27	SOEU "Jane Sandanski"	Manastir	Manastir	maqedonisht
28	OSMU "Nikolla Shtejn"	Tetovë	Tetovë	maqedonisht, shqip, turqisht
29	SOSU "Ilinden"	Mralino	Ilinden	maqedonisht
30	SOU Gjimnazi "Dobri Daskallov"	Kavadarci	Kavadarci	maqedonisht
31	SOU "Mitko Penxhukliški"	Kratovë	Kratovë	maqedonisht
32	OSU "Sh. Kliment Ohridski"	Ohër	Ohër	maqedonisht
33	SEPUGS "Vasil Antevski Dren"	Shkup	Kisela Voda	maqedonisht
34	SOU Gjimnazi "Dr. Ibrahim Temo"	Strugë	Strugë	maqedonisht, shqip, turqisht
35	SOU Gjimnazi "Goce Dellçev"	Kumanovë	Kumanovë	maqedonisht
36	SOU "ATA"	Qendër Zhupa	Qendër Zhupa	maqedonisht, turqisht

Nr.		Vendi i populluar	Komuna	Gjuha e mësimdhënies
37	SSOU "Kiro Burnaz"	Kumanovë	Kumanovë	maqedonisht, shqip
38	SOU "Orde Çopela"	Prilep	Prilep	maqedonisht
39	OSU "Mirko Mileski"	Kërçovë	Kërçovë	maqedonisht, turqisht
40	SOU "Sh. Kiril dhe Metodij"	Negotinë	Negotinë	maqedonisht
41	SSOU "Kole Nedellkovski"	Veles	Veles	maqedonisht
42	OSEU "8 Septemvri"	Tetovë	Tetovë	maqedonisht, shqip
43	SOU "Ismet Jashari"	Likovë	Likovë	shqip
44	OSU "Aco Ruskovski"	Berovë	Berovë	maqedonisht
45	SOU "Gostivar"	Gostivar	Gostivar	maqedonisht, shqip, turqisht
46	SUGS "Nikolla Karev"	Shkup	Karposh	maqedonisht
47	SOU "Gjimnazi "Koço Racin"	Veles	Veles	maqedonisht, shqip
48	SOU "Dimitar Vllahov"	Strumicë	Strumicë	maqedonisht
49	SOU "Taki Daskallo"	Manastir	Manastir	maqedonisht
50	SOU "Gjorgji Naumov"	Manastir	Manastir	maqedonisht
51	SOU "Gjorçe Petrov"	K. Pallankë	K. Pallankë	maqedonisht
52	SOU "Koço Racin"	Sv. Nikole	Sv. Nikole	maqedonisht
53	SOU "Bogdanci"	Bogdanc	Bogdanc	maqedonisht
54	OSSU "Gjoce Stojčevski"	Tetovë	Tetovë	maqedonisht, shqip
55	SUGS "Vllado Tasevski"	Shkup	Aerodrom	maqedonisht, shqip
56	"Vanço Prke"	Vinica	Vinic	maqedonisht
57	SOU "Mile Janevski Xhingar"	Kamenica M.	Kamenica M.	maqedonisht
58	OUTU "Vanço Pitoshevski"	Ohër	Ohër	maqedonisht
59	SOU "Naum Naumovski Borçe"	Probishtip	Probishtip	maqedonisht
60	SOU "Gjorçe Petrov"	Prilep	Prilep	maqedonisht
61	SOU "Niko Nestor"	Strugë	Strugë	maqedonisht, shqip
62	SOU "Dimitar Mirasçiev"	Shtip	Shtip	maqedonisht
63	SUGS "Braça Milladinovci"	Draçevë	K. Voda	maqedonisht, shqip
64	"Kosta Susinov"	Radovish	Radovish	maqedonisht, turqisht
65	SUGS "8-mi Septemvri"	Shkup	Gazi Baba	maqedonisht, shqip
66	SUGS "Dimitar Vllahov"	Shkup	Aerodrom	maqedonisht, shqip, turqisht
67	SOU "Jane Sandanski"	Shtip	Shtip	maqedonisht
68	OSTU "Nace Bugjoni"	Kumanovë	Kumanovë	maqedonisht, shqip
69	SSOU "Dimitrija Çupovski"	Veles	Veles	maqedonisht
70	"Goce Dellçev"	Vallandovë	Vallandovë	maqedonisht
71	SEPUGS "Arsein Jovkov"	Shkup	Butel	maqedonisht, shqip
72	SOU Gjimnazi "Sami Frashëri"	Kumanovë	Kumanovë	shqip

Shtojca 3: VIZITA NË SHKOLLA (faza 2. e hulumtimit)

Në gjysmën e dytë të marsit ishin kryer intervista me personat përgjegjës nga dhjetë shkolla të mesme, për të cilat ishte vlerësuar se kanë nevoja më të mëdha për zbatim të teknologjisë asistuese në mësim. Zgjedhja për vizitë në shkollat e mesme ishte kryer sipas mbledhjes së rezultateve nga pyetësi anketues:

1. SOU “Nikolla Karev”, Strumicë
2. SOU “Jane Sandanski”, Strumicë
3. SOU “Kosta Susinov”, Radovish
4. OSTU “Nace Bugjoni”, Kumanovë
5. SOU “Pero Nakov”, Kumanovë
6. SOU “Orde Çopella”, Prilep
7. SOEPTU “Kuzman Josifovski Pitu”, Prilep
8. SOU “Taki Daskallo”, Manastir
9. SUGS “Braça Milladinovci”, Draçevë
10. SEPUGS “Arseni Jovkov”, Shkup

Gjatë vizitave, ekipi i “Hapni dritaret” realizoi takime me anëtarë të ekipit profesional në shkollat e obliguara për ndjekje të mbështetjes së inkluzionit të nxënësve me NVA, dhe në disa shkolla ishte mundësuar bisedë e shkurtër me nxënës me nevoja të veçanta arsimore.

Me bashkëbiseduesit ishin kryer intervista gjysëm-strukturore, për të cilat ishte përgatitur udhëheqës për intervistë i përbërë nga katër kategori pyetjesh mbi bazë të cilave u fituan gjetje më të detajuara në pikëpamje të:

- strukturës së nxënësve me pengesë,
- inkluzivitetit të shkollës,
- përdorimit të kompjuterëve në mësim në punën me nxënës me NVA, dhe
- përdorues potencialë të teknologjisë asistuese.

Struktura e nxënësve me pengesë

Vizitat në shkolla dhe intervistat me përfaqësuesit e tyre, në pjesën më të madhe, i vërtetuan gjetjet nga hulumtimi anketues në pikëpamje të strukturës së nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

Gjatë vizitave ishte konstatuar mungesë e të dhënave precize dhe evidentimi sistematik i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. Evidentimi i nxënësve dallohet në çdo shkollë, dhe saktësia e të dhënave varet nga përgatitja profesionale e ekipeve shkollë për ta njohur pengesën. Për shembull të treja shkollat që përfshijnë defektolog në ekip dhanë pamje më të qartë për strukturën e nxënësve. Gjithashtu, terminologjia kontradiktore në lidhje me llojin e pengesës krijon vështirësi plotësuese në mbledhjen e të dhënave precize në lidhje me strukturën e nxënësve me NVA.

Edhe përkrah vështirësive me të cilat përballen, në shkollat e vizituara mund të vihen re qartësisht përpjekjet që i investon ekipi për të organizuar model vetjak për evidentim dhe ndjekje të nxënësve me NVA. Për shembull, pedagogu nga SOU “Orde Çopella” nga Prilepi kishte përgatitur formular për vlerësim të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Formulari përmbante shpjegim të detajuar për formën e pengesës dhe drejtime për mësuesin se si ta njohë. Në atë mënyrë mësuesit i identifikojnë më lehtë vështirësitë tek nxënësi dhe i raportojnë tek shërbimi profesional.

Inkluziviteti i shkollave

Gjetjet nga hulumtimi anketues në pikëpamje të inkluzivitetit të shkollave ishin të vërtetuara edhe në terren.

Të gjitha shkollat e vizituara janë të ndërtuara para më shumë se tridhjetë vitesh dhe e pasqyrojnë kohën në të cilën janë ndërtuar. Mundime të dukshme që të përmirësohet qasja janë platformat e pjerrëta për qasje në hyrjet kryesore ose hyrjet dytësore të shkollës. Edhe pse pjesa më e madhe e shkollave kanë qasje të lehtësuara në hyrje, pjesa e brendshme e objekteve është plotësisht e paarritshme përveç se në dy raste (në njërin ka ashensor të brendshëm, dhe tjetra është vetëm me kat përdhes).

Megjithatë, qendrimi pozitiv në këto dhjetë shkolla, në lidhje me inkluzionin, e tejkalojnë boshllëkun që e krijojnë barrierat fizike. Për shembull, pjesa më e madhe e bashkëbiseduesëve shpjeguan se shkollat e përshtatin mësimin për nxënësit me pengesa trupore në katet përdhes. Disa persona nga të pyeturit theksuan gadishmëri që t'i përshtatin edhe tualetet, përderisa për atë shfaqet nevojë.

Shumica e bashkëbiseduesëve konsideronin se ekipet e tyre kanë nevojë për mbështetje profesionale nga defektolog, duke ofruar zgjidhje të përshtatura lokale. Për shembull, drejtoresha e SOU "Kosta Susinov" nga Radovishi, konsideron se në vendet më të vogla ku ka vetëm një shkollë fillore dhe një shkollë të mesme, është e mjaftueshme që komuna të angazhojë një defektolog mobil që do t'i shërbejë të dyja shkollat.

Gjithashtu, bashkëbiseduesit e theksonin nevojën që të sigurohen trajnime plotësuese për mësuesit dhe ekipet profesionale për punë me nxënës me nevoja të veçanta arsimore, veçanërisht për përpunim të planeve individuale arsimore.

Të gjitha shkollat kanë marrë pjesë në iniciativa dhe projekte për përmirësim të inkluzivitetit, dhe si shembull ishin theksuar aktivitete të përbashkëta me shoqata lokale dhe qendra për persona me pengesa, trajnime për sensibilizim etj. dy shkolla janë përfshirë në projekt për mbështetje rajonale për arsim inkluziv të financuar nga BE. Dhe pesë shkolla në aktivitetet e Rrjetit JES dhe USAID për përmirësim të punësimit të personave të rinj.

Të gjithë bashkëbiseduesit konsideronin se është e nevojshme të vazhdojnë mundimet për përmirësim të kushteve për inkluzion të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

Përdorimi i kompjuterëve në mësim me nxënës me NVA

Në këtë pjesë, bashkëbiseduesit theksonin se pajisja standarde kompjuterike u shkakëton vështirësi disa nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. Si për shembull ishin theksuar nxënës me hemiparezë dhe paralizë cerebrale dhe shikim të dobët dhe pengesë intelektuale (për shkak të përdorimit të tastierave dhe mausave (minjve) standardë).

Në pesë nga shkollat e vizituara ka nga një komplet pajisje asistuese: xhojstik të adaptuar, trakboll, klike të veçuara dhe tastierë me butona të mëdha. Kompletet i kanë fituar drejtpërdrejt para intervistës në kuadër të projektit të Rrjetit JES. Pajisjet asistuese ende nuk përdoren dhe pritet t'i venë në funksion nga viti i ardhshëm shkollor. Në këto shkolla ekipet profesionale ishin të njohura edhe me përshtatjet me opsionet qasëse të sistemit operativ Windows 7.

Në shkollat e tjera, mes së tjerave, vizitat ishin të shfrytëzuara edhe të ndahen informacionet rreth aplikimit të teknologjisë asistuese në punën me nxënës me nevoja të veçanta arsimore.

Të anketuarit në të gjitha shkollat e vizituara u shprehën se kompjuteri mund të ndikojë në mënyrë pozitive në përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta dhe në përfshirjen e tyre aktive në mësim.

Përdoruesit potencialë të teknologjisë asistuese

Në tre shkolla ekipi hulumtues kishte mundësi të njohë dhe mbikëqyrë gjithësej nëntë nxënës me nevoja të veçanta arsimore. Pjesë prej tyre ishin të mbikëqyrur gjatë kohës së orës së mësimi, dhe me një pjesë prej tyre ishin kryer biseda direkte. Në mënyrë të përgjithshme, nxënësit konsideronin se teknologjia asistuese mund tua lehtësojë përdorimin e kompjuterit.

Vizitat në shkolla dhe biseda me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore ishte mundësi e mirë që anëtarët e ekipit hulumtues të identifikojnë përdorues potencialë të teknologjisë asistuese.

Zgjedhja e shkollave

Pas realizimit të të dyja fazave të hulumtimit, ishin zgjedhur dy shkolla të mesme që do të fitojnë mbështetje nga “Hapni dritaret” në kuadër të Projektit të USAID për e-arsim (arsim elektronik) të disponueshëm: SOU “Orde Çopela” nga Prilepi dhe SOU “Braça Milladinovci” nga Shkupi. Të dyja shkollat do të jenë të pajisura me teknologji informative asistuese dhe do të fitojnë trajnim për përdorimin e saj në punën me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.